

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjiilan-dega në Kamenicë, përmes gjyqtares së vetme Valbonë Dërvodeli, me sekretaren juridike Emine Zubaku, në çështjen penale kundër të akuzuarve H.B., A.I, L.D. që të tre nga, për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor si bashkëzekutor në bashkëveprim nga neni 154 parag.1 nënpar. 5 lidhur me nenin 23 të KPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së PPK-së nga Gjilani PP.nr.130/2009 të dt.14.05.2009, në shqyrtimin e hapur gjyqësor në prezencën e të akuzuarve H.B. e A.I., më dt.10.07.2015 komunikoi, ndërsa më dt.07.08.2015 përpiloi këtë,

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit,

1.H.B., në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë i dënuar më parë për vepër penale, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

2.A.I., në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë i dënuar më parë për vepër penale, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

J a n ë f a j t o r

Më datë 17.01.2009, rreth orës 00.30 min, në diskotekën “...”, në të cilën mbahej një koncert, pas një mosmarrëveshje që kanë pasur gjatë vallëzimit dy grupe të rinjesh, në mesin etyre edhe i dëmtuari L.Z. i cili ishte duke konsumuar alkool-birrë, intervenojnë punëtorët e sigurimit të kompanisë “Kosova Sekuriti” të akuzuarit H.B.,A.I. dhe L.D. ku gjatë largimit të të dëmtuarëve, L.Z. e G.Z. me dhunë nga diskoteka, të dëmtuarit L.Z. i shkaktojnë lëndime serioze, ku fillimisht kërkon ndihmë mjekësore në shtëpinë e shëndetit në e më pas në Spitalin Regjional të Gjiilanit , gjë që vërtetohet me ekspertizën mjeko ligjore me të cilën u konstatua se i dëmtuari L.Z. ka lëndime të rënda trupore-të cilat lëndime kanë shkaktuar dëmtim të përkohshëm të shëndetit .

- me çka si bashkëekzekutor në bashkëveprim kanë kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 154 parag. 1 nënparag. 5 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Andaj gjykata duke u mbështetur në nenin 4,41,50,51,52,73,75 dhe nenin 365 të KPPRK-së, të akuzuarëve, ju shqipton

Dënim me kusht

Ashtu që të akuzuarve, ju caktohet dënim me burgim në kohëzgjatje secilit prej nga 6 (gjashtë) muaj, ekzekutimi i të cilit dënim nuk do të bëhet nëse të akuzuarit mbrenda afatit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryejnë veprë tjetër penale, në rast se të akuzuarit kryejnë veprë tjetër penale, mbrenda afatit të verifikimit atëherë dënimi me kusht ka për t'iu revokuar në dënim me burg.

I dëmtuari L.Z. nga fsh....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil

I dëmtuari G.Z. nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike .

Detyrohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale –ekspertizës mjeko ligjore të paguaj shumën prej 40.88 €, në mënyrë solidare secili prej nga 20.44 €, si dhe paushallin gjyqësor të paguajë shumën prej 40 €, në mënyrë solidare secili prej nga 20 € krejt këto në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi

A r s y e t i m

Prokuroria Publike Komunale në Gjilan, me aktakuzën PP.nr.130/2009 të dt.14.05.2009, ka akuzuar H.B., A.I., L.D., që të tre nga, për shkak të veprës penale lëndim i rendë trupor në si bashkekzekutor në bashkëveprim nga neni 154 parag.1 nënpar. 5 lidhur me nenin 23 të KPK-së, pran të cilës ka mbetur edhe në fjalën përfundimtare me propozim që të akuzuarit të deklarohen fajtor dhe të dënohen në përputhje me ligjin.

Gjykata konform nenit 36 të KPPRK-së ka bërë veçimin e procedurës penale për të akuzuarin L.D., pasi i njëjti për momentin është i paarritshëm për gjykatën ashtu që procedura penale për të njëjtin do të zhvillohet dhe të përfundohet ndaras.

I dëmtuari L.Z. në shqyrtimin kryesor të datës 07.05.2014, i'u ka bashkangjitur ndjekjës penale dhe ka kërkuar kompenzim të dëmit,

I dëmtuari G.Z. në shqyrtimin kryesor të datës 07.05.2014 i'u ka bashkangjitur ndjekjës penale ndërsa nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

I akuzuari H.B. në mbrojtjen e tij nuk ka kontestuar faktin se natën konkrete ka punuar në diskotekën “.....” në të cilën diskotekë ka punuar që nga viti 2005, detyra e tij ka qenë në hyrje të diskotekës ku janë kontrolluar mysafirët, ndërsa afër ti ka qenë kolegu L.D. i cili ka dhënë bileta ndërsa punëtorët e tjerë të sigurimit kanë qenë në sallë, nuk i kujtohet saktë ora por i kujtohet se kolegu i tij D. deri te dera e diskotekës e ka sjellë L. për ta larguar, pasi i njëjti kishte prishur rendin dhe qetësinë në

sallë, mirëpo L. ka kundërshtuar të dal nga diskoteka pasi ka rezistuar është detyruar ta kap me forcë por pa e lënduar ta largoj deri te dera , pas pak ka ardhur një veturë e policisë dhe është marr me rastin, i dëmtuari lëndimet ka mund ti marr nga persona tjerë që janë rrahur në diskotekë nuk ka parë se ndonjë punëtorë i sigurimit ta ketë goditur të dëmtuarin, ndërsa me G.Z. janë takuar pas këtij rasti kanë pirë kafe dhe nuk kanë pasur problem. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e ndien vetën fajtor dhe kërkon nga gjykata që t'i shqyrtoj të gjitha provat sa ma drejtë dhe ta liroj nga përgjegjësia penale , po që se gjykata gjen prova dhe më shpallë fajtor , propozon që ti shqiptoj një dënim sa më të butë , është familjar, mbajtës i familjes dhe deri te kjo situatë është ardhur gjatë kryerjes së detyrave të punës dhe nuk ka pasur qëllim që ta lëndoj tani të dëmtuarin natën kritike.

I akuzuari A.I. në mbrojtjen e tij nuk ka kontestuar faktin se në vitin 2009 ka punuar në cilësinë e sigurimit në diskotekën “.....”, puna e tij ka qenë që të qëndrojë te dera e diskotekës e më vonë tek bina e këngëtarëve , diku rreth orës 24.00 ka filluar një rrahje ku prezent kanë qenë K.M., A.A., I.D, L e G.Z. dhe B.M., pasi këto grupe kanë filluar të rrahën fillimisht e ka larguar K.M. nga diskoteka dhe pasi ka qenë shumë afër incidentit i pari ka intervenuar pas tij ka intervenuar edhe punëtori tjetër i sigurimit D.D. i cili L. e ka larguar nga salla, personalisht ka parë se K.M. e ka goditur njërin nga të dëmtuarit nuk i kujtohet sa herë e ka goditur K.,L. por kjo ka ndodhur deri sa ky ka intervenuar për t'i ndarë, natën kritike nuk ka pasur kurrfarë kontakti me të dëmtuarit dhe nuk e di se çka ka ndodhur jashtë sallës. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e ndien vetën fajtor dhe kërkon nga gjykata që t'i shqyrtoj të gjitha provat sa ma drejtë dhe ta liroj nga përgjegjësia penale, po që se gjykata gjen prova dhe më shpallë fajtor, propozon që t'i shqiptoj një dënim sa më të butë , është familjar, mbajtës i familjes dhe deri te kjo situatë është ardhur gjatë kryerjes së detyrave të punës dhe nuk kanë pasur qëllim që ta lëndojnë dikën.

Gjykata në procedurën provuese ka ndëgjuar të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit dhe dëshmitarët si dhe bëri shiqimin dhe leximin e provave materiale bashkangjitur lëndës si: vërtetimin mbi kthimin e sendeve me nr. 2009-CB-012 datës 21.01.2009, mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko ligjor për të dëmtuarin L.Z. të datës 04.05.2009, raportin nga Spitali Regjional i Gjilanit në emër të G.Z. me nr. 765 datës 17.01.2009, raporti mjekësor i ordinances specialistikës kirurgjisë ASEPSA në emër të Liridon Zeqirit, raporti nga ordinanca specialistikës Neuropsikiatrike dhe Neuroimazherike hipokrati dates 17.01.2009 në emër të L.Z., fletlëshimi me epikrizë I Spitalit Regjional të Gjilanit me nr. 309/67 datës 21.01.2009 në emër të L.Z., raporti mjekësor i poliklinikës “Kirurgjikos” me nr.948/2009 datës 17.01.2009 në emër të L.Z.

I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit L.Z. në dëshminë e tij në shqyrtimin kryesor të datës 18.12.2013, nuk konteston faktin se natën kritike ka qenë në diskotekën “.....” në, së bashku me

vëllaun G. e djalin e hallës B.M., së bashku me djalin e hallës kanë porositur nga një birrë dhe gjatë qëndrimit në diskotekë dikush e ka shtyrë e nuk e di se kush ka qenë, i njëjti i ka kërkuar falje dhe i ka thënë se kjo po ndodhë për shkak tollovisë në diskotekë, kjo është përsërit edhe njëherë, në ato momente kanë ardhur punëtorët e sigurimit të diskotekës L.D., D.D. dhe A.F. e kanë kapur në shpindë për ta larguar nga diskoteka, në sallë të gjykimit i dëmtuari bënë identifikimin e personit-A.I i cili në korridor të diskotekës me gju i ka ra në bark dhe në kokë ku ka marr lëndime, ka humb vetëdijen dhe nuk di më për lëndime tjera, gjatë largimit nga diskoteka e kanë sulmuar tre persona, ndërsa deri sa ka qenë me vetëdije, natën kritike i kanë humbur 52 euro një zingjir i arit i vlerës 70-80 euro .

I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit G.Z. në dëshminë e tij ka deklaruar se është e vërtetë se në vitin 2009 , rreth orës 22-35 min, së bashku me vëllaun L. dhe nipin B.M. janë ardhur nga në diskotekën “.....” në, gjatë qëndrimit në diskotekë janë ndarë, ka qenë në katin e dytë të diskotekës , mirëpo pasi ka parë se në katin e parë ka një tollovi dhe punëtorët e sigurimit e kishin kap vëllaun e tij, derisa ka zbritur poshtë sigurimi vëllaun e kanë larguar nga diskoteka, jashtë diskotekës vëllaun e ka parë të shtrirë, nuk ka parë kush e ka goditur mirëpo pasi vëllaun L. është dërguar në emergjencë është konstatuar se i ka dy brinjë të thyer, në rastin konkret nuk ka njohuri se cilët persona kanë qenë të implikuar edhe unë kam qenë i goditur me grusht nga sigurimi mirëpo nuk e di nga kush.

Dëshmitari B.M. në dëshminë e tij ka deklaruar: se diku para 8 viteve së bashku me djemët e dajës L.e G me veturën e L. janë shkuar nga në diskotekën “.....”, ku së bashku me L. kanë porositura pije, ndërsa G.ka qenë diku për rreth, ka qenë tollovi e madhe disa të rinjë e kanë shtyrë L. , sigurimi i diskotekës pasi kanë parë tollovinë kanë intervenuar, L. dhe të tjetër që kanë qenë të përfshirë në rast i kanë larguar nga diskoteka, personi i quajtur J. i ka urdhëruar punëtorët e sigurimit që ta nxjerrin jashtë diskotekës L., i dëmtuar ka qenë i sulmuar nga 3-4 punëtorë të sigurimit edhe ate duke e sulmuar me grushta dhe njëri prej tyre me shqelëm në gjoks, pas pak janë ardhur policia të cilët e kanë thirr ambulanten ku së bashku me ta kam shkuar edhe unë, në mesin e punëtorëve të sigurimit kanë qenë edhe të akuzuarit të cilët e kanë sulmuar, ndërsa të akuzuarin H.B., për shkak tollovisë së madhe personalisht nuk e ka parë duke e goditur, sa i përket të dëmtuarit Gëzim nuk ka njohuri, nuk e ka parë dhe as dëgjuar ta ketë goditur ndokush.

Dëshmitari F.M. në dëshminë e tij ka deklaruar: se gjatë patrullimit jemi njoftuar se ka një përleshje në diskotekën “...”, në vend ngjarje ka pasur tollovi, një person ka qenë i shtrirë, për rrahjen që ka ndodhur e kanë informuar G. dhe B., personalisht ka thirr ambulancën, kanë marr deklaratë nga punëtorët e sigurimit, kanë kontaktuar me prokurorin e shtetit, dhe rasti ju është dedikuar hetimeve të mëtutjeshme, e nga kush është goditur L.nuk ka njohuri.

Dëshmitari I.O. në dëshminë e tij ka deklaruar: se natën kritike ka qenë në diskotekën “.....” si mysafir edhe atë kur ka ndodhur ngjarja ka qenë korridor para hyrjes në diskotekë duke qëndruar me

B.M. të cilin atëherë nuk e ka njohur ka parë se është alarmuar sigurimi se diçka ka ndodhur në diskotekë, kanë qenë diku 12-13 punëtor të sigurimit të cilit nuk i ka njohur , i kujtohet se personin me emrin G.punëtorët e sigurimit e kanë larguar nga salla e diskotekës, pas pak punëtorët e sigurimit nga diskoteka e kanë larguar edhe një person tjetër, për të cilin e kuptova se kishte qenë vëlla i G., L. i cili i kishte kundërshtuar puntorët e sigurimit, është rebeluar që të mos dal jashtë diskotekës me të parë G.vëllaun e vetë edhe ky ka rezistuar që të mos dal jashtë nga diskoteka ku kanë intervenuar 5-6 punëtorë të sigurimit të cilat i kanë tërhequr-larguar L. e G. nga diskoteka pasi të njëjtit kanë rezistuar që të dalin, ndërsa çka ka ndodhur jashtë nuk ka njohuri, qëllimi i punëtorëve të sigurimit ka qenë që ta parandalojnë më të keqën.

Dëshmitari J.K. në dëshminë e tij ka deklaruar: se punon polic, ndërsa natën kritike së bashku me bashkëshorten e tij ka qenë në vizitë në diskotekën “.....”, pasi bashkëshortja e tij është pronare e kompanisë së sigurimit në të cilën kanë punuar edhe tani të akuzuarit, L.Z. e ka njohur pasi i njëjti ka qenë në hetime për shumë vepra penale dhe duke ja njohur personalitetin e ka paralajmëruar bashkëshorten që të kërkoj nga punëtorët e sigurimit që të jenë më të kujdesshëm, pas një kohe shumë të shkurtër në katin e parë të diskotekës ka ndodhur një tollovi ku kanë intervenuar punëtorë e sigurimit dhe personat të cilët kanë shkaktuar problem i kanë larguar nga diskoteka, personalisht nuk i ka parë se cilët punëtorë të sigurimit i kanë sulmuar apo jo të dëmtuarit, personat të cilët bëjnë problem në diskotekë zakonisht nuk dalin me vullnet nga salla dhe ndaj tyre përdoret forca proporcionale, është e vërtetë se ka parë L.Z. të shtrirë dhe emergjencën e cila ka ardhur për ti marr personat e lënduar ka qenë i shqetësuar pasi bashkëshortja e tij është pronare e kompanisë së sigurimit dhe natën kritike ka shkuar pas emergjencës në spitalin Regjional të Gjilanit dhe ka parë se L. është liruar nga spitali menjëherë me një raport mjekësor.

Dëshmitari A.A. në dëshminë e tij ka deklaruar: se natën kritike ka qenë së bashku me I.D. në diskotekën, gjatë qëndrimit në diskotekë për shkak të tollovisë pa qëllim e ka prekur tani të dëmtuarin L.Z. i cili ka reaguuar, për shkak të sjelljeve-gjesteve të tij punëtorët e sigurimit e kanë larguar nga salla ndërsa unë në diskotekë kam qëndruar së bashku me I.D. edhe gjysmë ore se çka ka ndodhur jashtë diskotekës nuk e ka parë, por më pas ka dëgjuar se L. ka qenë i rrahur nga punëtorët e sigurimit ku më pastaj emergjenca e ka dërguar në Spitalin Regjional të Gjilanit

Dëshmitari I.D. në dëshminë e tij ka deklaruar: se natën kritike ka qenë në diskotekën me A.A., prej orës 22.00 deri ora 00.00, min, L. duke vallëzuar i ka shtyrë, i njëjti ka qenë duke konsumuar birrë, këtë e kanë vërejtur punëtorët e sigurimit të cilët edhe e kanë larguar jashtë diskotekës, natën kritike kanë qenë diku 13-14 punëtorë të sigurimit mirëpo të njëjtin e kanë larguar dy punëtorë të sigurimit e personat që janë në sallë të gjyqimit nuk janë personat që e kanë larguar nga diskoteka L., pas largimit të tij ende kanë qëndruar në diskotekë ndërsa çka ka ndodhur jashtë diskotekës nuk ka njohuri vetëm ka

ndëgjuar se është ardhur ambulanca e ka marr L., gjithashtu të nesërmen ka dëgjuar se L.ka fyer punëtorët e sigurimit dhe ka pasur problem me të njëjtit.

Dëshmitari D.D. në dëshminë e tij ka deklaruar: se natën kritike ka punuar roje brenda në diskotekë diku ka mesnata ka parë dy grupe të përfshira në konflikt në mes vete, pasi ka parë se kanë pasur shishe të alkoolit ka hyrë në mes si preventivë për ti ndarë , në momentin kur ka hyrë në mes të grupeve ka kapur dy persona të cilët kanë qenë më agresiv, i ka larguar deri në korridor të diskotekës, duke ju thënë punëtorët të sigurimit që mos ti lejojnë të hynë brenda këta persona pasi të njëjtit kanë qenë agresiv, ka pasur numër të madh të njerëzve nuk i kujtohet se në korridor të diskotekës a kanë qenë tani të akuzuarit H.B. e A.I., nuk ka njohuri se çka ka ndodhur jashtë diskotekës.

Dëshmitari S.I. në dëshminë e tij ka deklaruar: se nuk i kujtohet data e rastit konkret por i kujtohet se në diskotekën “.....” patrulla e policisë ka vërejtur një tollovi të cilët kanë raportuar në stacionin policor se është një përleshje, policia fillimisht kanë thirr ambulancën, ku të lënduarit janë dërguar në QKMF nëe më pas në spitalin Regjional të Gjilanit, kanë kontaktuar me rojën e objektit K.M. i cili i ka njoftuar se disa persona pasi kanë konsumuar alkool kanë prishë rendin në diskotekë kështu që personat e sigurimit janë detyruar ti largojnë këta personal nga diskoteka, natën kritike kanë punuar disa persona të sigurimit e në mesin e tyre kanë qenë edhe H.B. e A.I., të dëmtuarit pasi nuk ju janë bindë urdhrave të punëtorëve të sigurimit të njëjtit janë detyruar të përdorin forcën ndaj tani të dëmtuarëve dhe ti largojnë me forcë nga diskoteka, të dëmtarëve nuk ju është bërë alkool testi pasi të njëjtit janë dërguar menjëherë në spitalin e Gjilanit por nga dëshmitarët okular jemi informuar se tani të dëmtuarit natën konkrete kanë qenë duke konsumuar alkool.

Nga shkresat e çështjes dhe nga provat që janë proceduar në këtë çështje penale juridike, nuk janë kontestuese faktet: se në diskotekën “.....” gjatë një mosmarrëveshje që kanë pasur gjatë vallëzimit i dëmtuari L.Z. me një grup të rinjsh kanë intervenuar punëtorët e sigurimit të kompanisë “Kosova Siguriti” të akuzuarit H.B., A.I. dhe L.D. ku gjatë largimit të të dëmtuarëve L. e G.Z. me dhunë nga diskoteka të dëmtuarit L.Z. i shkaktojn lëndime serioze ku fillimisht i njëjti kërkon ndihmë mjekësore në ambulancën e e më pas në spitalin regjional të Gjilanit, gjë që vërtetohet me ekspertizën mjeko ligjore me të cilën është konstatua se i dëmtuari L.Z. ka pësuar lëndime të rënda trupore të cilat lëndime kanë shkaktuar dëmtim të përkohshme për shëndetin .

Gjykata ua ka falur besimin dëshmisë së të dëmtuarëve në cilësi të dëshmitarëve L. e G.Z. ngase dëshmitë e tyre ishte bindëse pasi të njëjtat ishin në përputhje dhe nuk ranë në kundërshtim edhe me provat tjera të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor si me: me deklaratën e dëshmitarit B.M. i cili në dëshminë e tij ka deklaruar se në diskotekën ka pasur një problem në mes të disa të rinjve në mesin e tyre ka qenë edhe L. dhe pasi është shkaktuar kjo tollovi kanë intervenuar punëtorët e sigurimit për ti larguar nga diskoteka, kanë qenë 3-4 punëtorë të sigurimit të cilët duke e sulmuar L. e kanë larguar nga

diskoteka e në mesin e punëtorëve të sigurimit kanë qenë edhe të akuzuarit, dëshmitari F.M. me dëshminë e tij ka vërtetuar se natën kritike ka pasur një përleshje në diskotekën “.....” ku është ftuar patrulla policisë, ambulanca dhe rasti ju është dedikuar hetimeve. Edhe nga dëshmit e dëshmitarëve I.O. , J.K. dren A., I.D. , D.D. , gjykata vërtetoi se natën kritike në diskotekën ka ndodhur një përleshje në mes dy grupeve të rinjsh me ç ‘rast kanë intervenuar punëtorët e sigurimit kanë larguar L., G. të cilët kanë rezistuar që mos të dalin jashtë nga diskoteka, në vend të ngjarjes ka arritur patrulla e policisë dhe më pas emergjenca e cila e ka dërguar L. në Spital, e nga dëshmia e dëshmitarit S.I. gjykata vërtetoi se disa persona në diskotekën “.....” pasi kanë konsumuar alkool punëtorët janë detyruar ti largojnë këta persona nga diskoteka , natën kritike kanë punuar disa punëtorë të sigurimit mirëpo në mesin e tyre kanë qenë edhe H.B. e A.I., të dëmtuarit pasi nuk ju janë bindur urdhrave të sigurimit të njëjtit janë detyruar ta përdorin forcën dhe ti largojnë me forcë nga diskoteka .

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuari H.B., i cili nuk kontestoi se natën kritike ka pasur mosmarrëveshje në mes dy grupeve në diskotekën , mirëpo mohon ta ketë goditur të dëmtuarin L. apo G.Z. , i njëjti deklaroi se pasi L. ka kundërshtuar të dal nga diskoteka ka qenë i detyruar ta kap me forcë por pa e lënduar ta largojë deri te dera dhe lëndimet ka mundur ti marr nga dikush tjetër, gjykata mbrojtjes së tij nuk ia falë besimin pasi mbrojtjen e tij e konsideron të pabazuar dhe në kundërshtim me të gjitha provat e shtjelluara, e këtë e ka bërë me qëllim që ti shmanget përgjegjësisë penale për veprën penale për të cilën akuzohet, në dhënien e deklaratës në polici i njëjti ka pranuar se pasi ka qenë i goditur me grusht në kokë duke u mbrojtur edhe ai e ka goditur , pra mbrojtja e të akuzuarit ra në kundërshtim edhe me deklaratën e të akuzuarit dhënë në procedurat e më hershme, gjithashtu gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit A.I. i cili nuk kontestoi se natën kritike ka pasur përleshje në mes dy grupeve në diskotekën “.....”, ka intervenuar personalisht për ti ndarë mirëpo mohon që ti ketë goditur të dëmtuarit, nga deklaratat e të dëmtuarit L.Z. gjykata vërtetoi se i akuzuari A.I. e ka goditur të njëjtin e këtë e vërteton edhe dëshmitari tjetër B.M., andaj gjykata mbrojtjes së tij nuk ia falë besimin pasi e konsideron të pabazuar dhe në kundërshtim me provat tjera të shtjelluara, e këtë e ka bërë me qëllim që ti shmanget përgjegjësisë penale për veprën penale për të cilën akuzohet .

Nga faktet që u parashtruan më parë, qartë rezultoi se janë përmbushur të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale si bashkëveprim lëndim i rëndë trupor nga neni 154 parag. 1 nënparag.5 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Me rastin e vendosjes mbi llojin dhe lartësinë e sanksionit penal ndaj të akuzuarëve për veprën penale që e kanë kryer, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, ndikojnë që dënimi të jetë më i lehtë apo më i rëndë, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin H.B. mori: sjelljen korrekte në gjykatore, mbajtës i familjes, koha nga kryerja e veprës penale, bashkëpunues me gjykatën, i njëjti nuk ka pasur qëllim dhe paramendim që ta lëndoj dikën por detyra e tij zyrtare ka qenë

të mbaj rendin dhe qetësin në lokalitetin ku ka punuar e qëllimi kryesor në rastin konkret ka qenë të ndërpres më të keqën e mundshme, ndërsa për të akuzuarin A.I. si rrethanë lehtësuese mori: sjelljen korrekte në gjykatore, mbajtës i familjes, koha nga kryerja e veprave penale, i papunë, gjendjen jo të mirë ekonomike, i njëjti nuk ka pas qëllim dhe paramendim që ta lëndoj dikën por detyra e tij zyrtare ka qenë të mbaj rendin dhe qetësin në lokalitetin ku ka punuar e qëllimi kryesor në rastin konkret ka qenë të ndërpres më të keqën e mundshme, ndërsa rrethanat veçanarisht rënduese ndaj tyre nuk gjeti. Për këtë arsye kjo Gjykatë vlerëson se në rrethanat të tilla edhe vetëm kërcënimi me dënim, është i mjaftueshëm për arritjen e qëllimit të dënimit në segmentin preventiv individual dhe gjeneral .

I dëmtuari L.Z. nga fsh, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil .

I dëmtuari G.Z. nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike .

Vendimin mbi paushallin gjyqësor gjykata e mbështeti në dispozitat e nenit 453 lidhur me nenin 450 të KPPRK-së.

Gjykata nga të cekurat më lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN- DEGA NE KAMENICE,

Më datën 07.08.2015,P.365/2014

Procesmbajtësja

Gj y q t a r j a

Emine Zubaku,d,v

Valbonë Dërvodeli,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej

15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, Gjykatës së

Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.